



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 4500/g Prot.

Pogradec, më 23.12.2025

VENDIM

NR. 127 , DATË 22.12.2025

PËR

**“MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 TË BASHKISË
POGRADEC (Faza III)” DHE “MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE
BUXHETORE PËR VITET 2026-2028”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b” dhe nënpika 1.3, shkronja “c”, nenit 34, pika 6, nenit 41, pika 1 dhe pika 2 shkronja “d”, nenit 54, shkronja “dh” dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" të ndryshuar, nenit 36 të Ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" të ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar, Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 16.05.2024, "Për një shtesë në Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar", Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJVQV" të ndryshuar, Udhëzim Nr.8 datë 28.02.2025, "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028" me shtojcat plotësuese, shkresa nr. 937/20 prot dt 09.12.2025 për procesin e konsultimit publik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Miratimin Tavaneve Përfundimtare Buxhetore dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (faza III) të Bashkisë Pogradec, për vitet 2026-2028 sipas relacionit shpjegues për procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (Shtojca 2, Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028) bashkëlidhur dhe formatet si më poshtë:

Adresa: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: nr.2, Pogradec - Shqipëri Tel: +355 83 22222 E-mail: bashkiapogradec@gmail.com





- 1.1 PBA1-Tavanet Përfundimtare
- 1.2 PBA2-Parashikimi i të ardhurave
- 1.3 PBA3-Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas klasifikimit ekonomik
- 1.4 PBA4-Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas klasifikimit funksional
- 1.5 PBA5-Shpenzimet sipas programit dhe klasifikimit ekonomik
- 1.6 PBA6-Deklarata e politikës së programit
- 1.7 PBA7-Shpenzimet e produkteve të programit
- 1.8 PBA8-Projektet e investimeve
- 1.9 PBA9-Informacion mbi NJVQV

2. Për zbatimin e vendimit ngarkohen Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar ,të gjitha ndërmarjet në varësi të Bashkisë Pogradec.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55,të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",të ndryshuar.

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT

Albana PRIFTI

1.Miratuar me 20 vota

2.Vota Pro 20

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 3

5.Zbardhur më date 23.12.2025

Adresa: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: nr.2, Pogradec - Shqipëri Tel: +355 83 22222 E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

